



Adhurimi: Çelësi për të kuptuar teuhidin dhe tekfirin

Description

Hatem el-Auni

Burimi: Dr. H?a?tim ibn ‘Arif al-‘Awni? al-Shari?f, *Worship: Gateway to Tawh?i?id. . . and to Takfi?r*, trans. Farh?a?n S?iddi?qi? (Adalah Publications), pp. 1-33.

Hyrje

Kurdo që përmendet fjala “adhurim”, gjëja e parë që të vjen ndër mend është marrëdhënia më e rëndësishmja ndër të gjitha marrëdhëniet – marrëdhënia e njeriut me Krijuesin e tij, i madhërishëm e i lartë është Ai. Kjo, në të vërtetë, është arsyeja e ekzistencës së njerëzimit dhe e xhinëve:

“Nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër veçse të më adhurojnë”. (edh-Dhaarijaat, 56)

Çka është ky adhurim, nëpërmjet të cilit ne e realizojmë teuhidin, punën më madhështore?

Çka është ky teuhid, nëpërmjet të cilit ndodh gjynahu më i madh njerëzor – shirku[1]?

Çka është ky koncept i adhurimit që, kur kuptohet si duhet, e dallon besimtarin monoteist nga jobesimtari politeist?

Përgjigjja në këto pyetje na e shpërfaq rëndësinë e konceptimit të duhur të adhurimit si edhe rrezikun e madh të moskuptimit të tij. Pikërisht këtë synoj ta sqaroj në këtë artikull të shkurtër.

Përdorimi i termit “adhurim”

Po e nis prezantimin për këtë temë me rëndësi tejet të madhe duke thënë se termi “adhurim” përdoret në dy mënyra:

1. Të përgjithshme
2. Të veçantë

Përdorimi i përgjithshëm

Përdorimi i përgjithshëm i termit “adhurim” përfshin tërë atë për të cilën shpërblehet një besimtar, ku bën pjesë:

- T’i afrohesh Allahut me lloje të ndryshme të adhurimit ritual, siç është namazi ose agjërimi.
- T’u bësh mirë të tjerëve
- T’u shërbesh prindërve
- T’i mbash lidhjet familjare
- Të sillesh mirë me njerëzit dhe me krijesat në përgjithësi.

Ky përdorim i fjalës “adhurim” mund të përkufizohet si: “Një term përgjithësues, që i përfshin të gjitha thëniet dhe veprimet (të fshehta e publike) me të cilat është i kënaqur Allahu”.[\[2\]](#)

Megjithëqë është me vend ta përkufizosh kështoj adhurimin (sipas përdorimit të gjerë), ky përkufizim nuk e qartëson dallimin mes teuhidit dhe shirkut. Çka është si qëllim në të vërtetë, kur themi se adhurimin lejohet t’ia drejtosh vetëm Allahut, kurse, kur atë ua drejton të tjerëve veç Allahut, është shirk?

Ta marrim për shembull shërbimin ndaj prindërve dhe sjelljen e mirë ndaj të tjerëve. Në bërjen e këtyre veprimeve mund të mos e kesh nijet t’i afrohesh Allahut. Megjithëkëtë, ne asnjëherë nuk do të thoshim se vepruesi i cilitdo nga këto dy veprime, është një gjynahqar, madje një idhujtar (*mushrik*). Domethënë, personi mund të jetë i mirë me prindërit dhe me të tjerët, pa e pasur si qëllim adhurimin. Nijeti i tij mund të jetë vetëm nderimi dhe respektimi i tyre si dhe arritja e lumturisë dhe e prehjes shpirtërore. Dhe ai e arrin këtë duke i bërë të lumtur ata që kanë qenë të mirë me të. Asnjë nga këto veprime nuk është as gjynah, as shirk. Mirëpo personi nuk do të meritojë ndonjë shpërblim për këto vepra të mira.[\[3\]](#) Këto janë thjesht veprime të lejueshme, që as nuk të afrojnë me Allahun, as nuk të largojnë nga Ai.

Kjo bëhet më e qartë atëherë kur dikush bën diçka për interes personal. Shembuj të kësaj janë ngrënia dhe pirja për ta ruajtur fuqinë trupore, fjetja për ta çlodhur atë, ose përmbushja e epshit seksual në mënyrë të ligjshme.^[4] Në të vërtetë, këtu hyn çdo vepër që i bën dobi trupit. Të gjitha këto veprime janë të lejuara dhe nuk tërheqin as gjynah, as sevap (shpërblim). Përjashtimi i vetëm do të ishte atëherë kur personi i bën këto në mënyrë të vetëdijshme me nijetin e fitimit të forcës për ta bërë atë që kënaq Allahun ose për t'iu shmangur asaj që e zemëron Atë. Në këtë rast, ngrënia dhe pirja është "adhurim" për të cilin shpërblehesh. Këto veprime përbëjnë "adhurim" jo ngaqë janë në vetvete akteadhurimi, por për shkak të nijetit që personi e bën lidhur me to.

Ky është adhurimi në kuptimin e tij të përgjithshëm, që është përkufizuar si: "Një term përgjithësues, që i përfshin të gjitha thëniet dhe veprimet (të fshehta e publike) me të cilat është i kënaqur Allahu". Kur adhurimi përdoret në këtë kuptim të përgjithshëm, nënkupton thjesht dëgjueshmëri që na afron me Allahun, më të lartin. Ky kuptim më i gjerë i adhurimit përfshin:

- Të gjitha aktet rituale të adhurimit (*ibaadaat mehde*)
- Veprimet e lejueshme të zakonshme (*aadaat mubaah*), me të cilat personi e bën nijet t'i afrohet Allahut. Kjo përfshin:
 - Ta duash Allahun
 - Ta falënderosh Atë për mirësitë e lejuara që i gëzon
 - T'u shmangesh akteve të mosbindjes ndaj Allahut
 - T'i përdorësh gjërat e lejueshme (të domosdoshmet, nevojat e përgjithshme, gjërat e dëshirueshme) për ta forcuar veten në kryerjen e asaj që e kënaq Allahun.

Do të vëresh se ky përkufizim nuk e qartëson kuptimin e "adhurimit" që e synojmë me diskutimin rreth adhurimit vetëm të Allahut (*teuhid el-ibaadaah*). Ky përkufizim nuk e sqaron llojin e adhurimit që, kur i drejtohet dikujt tjetër veç Allahut, e bën personin idhujtar (*mushrik*). Sipas këtij përkufizimi, fjala "adhurim" i referohet ngrënies dhe pirjes (me nijetin e forcimit të trupit për dëgjueshmëri ndaj Allahut) po aq sa i referohet agjërimit ritual dhe namazit ritual. Është më se e qartë se një përdorim i këtillë i përgjithshëm i termit "adhurim" nuk na ndihmon ta dallojmë teuhidin në adhurim nga shirku në adhurim.

Kjo është arsyeja përse një nga gabimet më të rënda në të kuptuarit e teuhidit dhe të shirkut është mospërkufizimi i adhurimit. Si do ta dallojë shirkun në adhurim nga teuhidi në adhurim personi që nuk e përkufizon "adhurimin" në raport me mënyrën e përdorimit të tij në diskutimin rreth teuhidit në adhurim?

Nëse kemi arritur ta përshkruajmë përmbledhtas përdorimin e parë të "adhurimit" sipas kuptimit të përgjithshëm, atëherë mbetet të shpjegohet përdorimi i dytë, që është kuptimi i veçantë i tij. Ky përkufizim do të na ndihmojë ta identifikojmë dallimin mes teuhidit dhe shirkut në raport me adhurimin.

Përdorimi i veçantë i adhurimit

Në kuptimin e veçantë adhurim është: ta lavdërosh e ta madhërosh Atë që e kontrollon tërë krijimin, Atë që e zotëron Mbretërinë, Atë që qeveris të gjitha çështjet, Atë që përshkruhet me përsosuri absolute – të gjitha cilësitë e veçanta për Të si Zot. Me fjalë të tjera, adhurim është: të lavdëroj dhetë të madhëroj Ty duke të dashur, dhe duke pasur droje, dhe duke e varur shpresën te Ti ndërsa epranoj atë çfarë është e veçantë për Ty si Zot.

Të gjitha cilësitë e sipërpërmendura paraqesin përshkrime të veçanta për të qenët Zot, dhe shirku ndodh atëherë kur cilado nga këto cilësi të veçanta i atribuohet dikujt tjetër veç Allahut, më të lartit, siç do të sqarojmë.

Ka dy lloje të “adhurimit” që ngatërrohen atëherë kur keqkuptohen:

1. Adhurimi i përgjithshëm, që e lejon personin ta bëjë atë “adhurim” për tjetërkënd veç Allahut[5]
2. Adhurimi i veçantë, që e bën personin të bjerë në shirk.[6]

Nëse e analizojmë kuptimin e përgjithshëm të “adhurimit”, teorikisht kjo mund të kufizohet në dy mënyra:

1. Duke e pasur parasysh vetë veprimin:
2. Një veprim i mirë që sjell shpërblim ose
3. Një veprim i keq që sjell ndëshkim
4. Duke e pasur parasysh atë që ndikon në veprim:
5. Pasja e nijetit të drejtë dhe zbatimi i urdhrave fetarë ose
6. Mospasja e nijetit të drejtë dhe / ose kundërshtimi i urdhrave fetarë

Nuk është e mundshme në asnjë mënyrë që “adhurimi” nga këto pikëpamje ta fusë personin në shirk. Së këndejmi, nijeti në adhurim (sipas kuptimit të veçantë) është ose veçim i Allahut me adhurim, ose shoqërim i ortakëve me Të. Dhe kjo mund të bëhet ose në formë më të lehtë (për kënaqësinë e tjetërkujt veç Allahut), ose në formë më të rëndë (duke i atribuuar tjetërkujt një cilësi që është e veçantë për Allahun). Ndryshe nga rasti i përkufizimit të përgjithshëm të “adhurimit”, këtu s’ka ndonjë mundësi tjetër.

Që të kuptohet nga vjen ky përkufizim, do t’i paraqes dy veprime që robi i Allahut i kryen zakonisht. I pari është një veprim që bëhet me zemrën e tij, i dyti është një veprim që bëhet me gjymtyrët e tij. Veprimi i parë është dashuria. Të gjithë e dimë se veprimi më madhor që një rob mund ta bëjë me zemër për Zotin e tij është dashuria, dhe ai s’do të jetë besimtar i vërtetë pa e bërë këtë. Në e dimë po ashtu se ta duash peygamberin (a.s.) është një adhurim në vetvete. Besimi ynë nuk do të jetë i saktë derisa ta duam atë. Besimi ynë nuk do të jetë i plotë derisa ta duam atë r më shumë sesa prindërit tanë, fëmijët tanë, tërë njerëzimin, madje dhe më shumë sesa veten tonë.

Atëherë, cili është dallimi mes dashurisë sonë për Allahun e lartësuar dhe dashurisë për peygamberin (a.s.) ? Cili është faktori përcaktues për shirk në dashurinë tonë për peygamberin (a.s.)? Me fjalë të tjera, cili është kriteri me të cilin ne i paralajmërojmë njerëzit lidhur me dashurinë për peygamberin (a.s.), në mënyrë që dashuria e tyre të mos jetë aq ekstreme sa ta arrijë nivelin e shirkut?

Mund të thuhet: A është kjo që ta duash atë r ashtu siç e do Allahun e lartë?

Them: Çfarë është kjo dashuri për Allahun, e cila nuk është e lejuar për ndokënd veç Tij?

Përgjigjja e vetme e mundshme është të thuhet: Kjo është që ta duash Atë në mënyrën që është veçantë për Të si Zot, meqë me këtë dashuri ti e hyjnizon këtë të dashur. Pra, ti e adhuron Atë me zemrën tënde.

Sado shumë që ta duash peygamberin (a.s.), kjo është një shtim në besim (iman) derisa dashuria ta arrijë në çfarëdo mënyre pikën e barazimit me Atë që e kontrollon tërë krijimin, Atë që e zotëron Mbretërinë, Atë që i rregullon të gjitha çështjet, Atë që përshkruhet me përsosuri absolute. Në këtë pikë, dashuria jote kalon në shirk.

E ngjashme me dashurinë është frika. Frika është një ndër llojet më madhështore të adhurimit që njeriu mund të bëjë me zemër. Ky adhurim nuk lejohet t'i bëhet ndokujt tjetër veç Allahut, më të lartit. Kjo e vë në hesap faktin se ti mund t'ua kesh frikën shumë edhe krijesave të tjera. Ka mundësi që personi të vdesë nga frika e paraqitjes së befasishme të ndonjë bishe, ndërsa të mos vdesë ose të mos alivanoset nga frika ndaj Allahut të madhërishëm. Por as me këtë nivel të frikës personi nuk do të quhej idhujtar (*mushrik*). Sepse frika prej bishës, është frikë prej një krijese që ti e di se nuk është Zoti yt.^[7] Në çastin që ti i frikësohesh një gjëje duke i atribuar një cilësi perëndie,^[8] ti e konsideron Zot dhe bën shirk.

Veprimi i dytë është sexhdeja për Allahun e lartë. Ky është një veprim i dukshëm dhe bëhet me gjymtyrë. Jakubi u i bëri sexhde Allahut:

“Këta janë ata, që Allahu i begatoi (me hirin e Tij) nga peygamberët pasardhës të Ademit, të atyre që Ne i mbartëm me Nuhun, nga pasardhësit e Ibrahimit dhe të Izraelit dhe nga ata që Ne i udhëzuam dhe i zgjodhëm. Kur iu lexoheshin vargjet e Mëshirëplotit, binin në sexhde dhe qanin”. (Merjem, 58)

Jakubi u, po ashtu, i bëri sexhde të birit, Jusufit (r.a.):

“Ai i ngriti prindërit e vet në fron dhe ata të gjithë i bën sexhde atij”. (Jusuf, 100)

S'ka dyshim se Jakubi (r.a.) i dallonte qartë këto dy sexhde. Ky dallim është i qartë sa edhe dallimi i veçimit të sinqertë të Allahut nga shoqërimi i ortakëve me Të (shirku). Vërej sesi në të dyja rastet (ajetet) folja / veprimi është i njëjta: “bëri sexhde”. Si e dalloi Jakubi sexhden për Allahun nga sexhdeja për Jusufin?

Njësoj edhe melaiket i bëjnë sexhde Allahut:

“Në të vërtetë, ato (melaiket) që janë afër Zotit tënd, nuk refuzojnë ta adhurojnë Atë, por e lavdërojnë dhe bien në sexhde para Tij”. (el-A'raf, 206)

Zoti i tyre i urdhëroi melaiket t'i bënin sexhde edhe Ademit dhe secila prej tyre e bëri këtë:

“Kur u thamë melaikëve “Bëjini sexhde Ademit”, ato (të gjitha) i bënë sexhde ...” (el-Bekare, 34)

Tash, si ka mundësi që sexhdeja që bëjnë për Allahun të jetë adhurim, pra, diçka e lavdërueshme, kurse sexhdeja që i bënë Ademit të mos jetë adhurim?

Kjo ka vetëm një përgjigje të pashmangshme: Sexhdeja e Jakubit drejtuar Jusufit dhe sexhdeja e melaikeve drejtuar Ademit ishte sexhde e një krijese drejtuar një krijese tjetër. Kjo nuk ishte sexhde që i drejtohej Krijuesit, Atij që e kontrollon tërë krijimin, Atij që e zotëron Mbretërinë, Atij që i rregullon të gjitha çështjet, Atij që përshkruhet me përsosuri absolute. Kjo është arsyeja përse sexhdeja drejtuar Jusufit dhe Ademit nuk përmbante elemente të shirkut, madje as ndonjë element të tërthortë që do të tregonte për shirk.

Duhet theksuar se këtu nuk po bëhet fjalë për vendimin lidhur me të bërit e sexhdes në traditën tonë. Në fenë tonë, sexhdeja është e ndaluar për dikë tjetër veç Allahut (xh.sh.). Vendimi për sexhden drejtuar dikujt tjetër veç Allahut në mesazhin e Muhamedit r, është i ndryshëm nga vendimi për këtë në traditat e tjera. Por teuhidi nuk është i ndryshëm në tradita të ndryshme dhe diskutimi ynë përqendrohet në këtë. Është e ndaluar t'i bësh sexhde dikujt tjetër veç Allahut, por nuk është shirk, përveç nëse personi me sexhde ka si qëllim një cilësi që është e veçantë për Allahun si Zot.

Ngjashëm me këtë, do të gjesh një dallim të theksuar mes qëndrimit në këmbë për prindërit e tu, për mësuesin tënd, ose për këdo që ti ke konsideratë dhe qëndrimit për Allahun gjatë namazit. Ti bën adhurim me qëndrim para Allahut në namaz. Kur i Dërguari i Allahut (a.s.) u pyet: “Cili është namazi më i mirë?”, ai u përgjigj: “Ta zgjasësh *kunutin*”.^[9] Domethënë, ta zgjasësh qëndrimin në këmbë në namaz. Kjo ndjesi e lëvdimit dhe e respektit ndaj një krijese, nëpërmjet qëndrimit në këmbë, në asnjë mënyrë nuk është e ngjashme me lëvdimin dhe respektin tënd ndaj Allahut, kur ti qëndron në këmbë për Të. Këtë respekt për Krijuesin, nëpërmjet qëndrimit tënd në këmbë, kurrë s'do ta tejkalojë respekti që ti ke për krijesat e ngjashme me ty. Ti nuk i rri në këmbë dikujt sikur ai të ishte një krijues që e kontrollon tërë krijimin, që e zotëron Mbretërinë, që i rregullon të gjitha çështjet, që përshkruhet me përsosuri absolute. Kjo qartazi do të dallonte nga qëndrimi yt në këmbë për Allahun, meqë ti rri në këmbë për Allahun, për Zotin tënd, për Krijuesin, për Zotëruesin e mbretërisë, për atë që i rregullon të gjitha çështjet, për Atë që përshkruhet me përsosuri absolute.

Në këtë diskutim shohim se realiteti i adhurimit është veprim i veçantë i zemrës. Dhe ky veprim nuk devijon, përveç me besimin se objekti i adhurimit është krijuesi, zotëruesi i mbretërisë, ai që i rregullon të gjitha çështjet, ai që përshkruhet me përsosuri absolute. Për sa u përket veprimeve të gjymtyrëve, ato janë:

- E lejuar (siç është qëndrimi në këmbë për prindërit e tu)
- E ndaluar (siç është t'i bësh sexhde dikujt tjetër veç Allahut)

Atëherë, këto nuk janë akte adhurimi, përveç nëse qëndrimi në këmbë ose sexhdeja përfshin në vete të besuarit në cilësi që janë të veçanta për Zotin.

Kjo është e vlefshme për të gjitha veprimet e dukshme (me gjymtyrë), siç është therja e një kafshe për mysafirin që ti e nderon dhe e respekton. Gjasat janë që ti nuk do ta bëjë këtë për dikë ndaj të cilit nuk ke konsideratë dhe ta ushqeje me atë që ti e vlerëson si të pranueshme (sipas traditës vendore). Në anën tjetër, ti bën kurban për Allahun në shenjë përnderimi dhe që ta përmbushësh ritualin e haxhit, bën kurban në kuptimin e përgjithshëm, ose për ta përmbushur një zotim. Kjo bëhet duke kërkuar afrim me Zotin tënd, Krijuesin, Zotëruesin e mbretërisë, Atë që i rregullon të gjitha çështjet, Atë që përshkruhet me përsosuri absolute. Kjo është e vlefshme për të gjitha veprimet e dukshme, që bartin

mundësinë ose të respektimit të dikujt nga krijesat, ose të vetë Krijuesit. Kjo nuk do të konsiderohet adhurim, përveç nëse, nëpërmjet atij veprimi, personi do të përnderonte duke përfshirë në këtë ato cilësi (kuptime) që janë të veçanta për Zotin.

Kështu, kushdo që i atribuon ndonjë cilësi perëndie dikujt tjetër veç Allahut të lartë dhe e përcakton atë qenie si unike ose si diçka që e ka aftësinë ta sfidojë mbretërinë ose ligjin e Allahut, ai është një idhujtar (mushrik).

Në këtë pikë, do të doja të theksoja diçka tejet të rëndësishme. Ky atribuim mund të marrë dy forma:

1. Besimi se një individ është i pavarur nga Allahu për sa i përket një cilësie që është e veçantë për Zotin. Kjo është shirk. Kjo është situata që kërkon të besosh në shumë zota. Si shembull të kësaj kemi fetë politeiste të cilat u atribuojnë cilësi perëndie një numri zotash të ndryshëm, ngjashëm me zotat grekë. Ky është imazhi i zakonshëm i shirkut ku shumica e shkollave të mendimit e mbështesin mendimin për këtë (shirk), pa e marrë parasysh imazhin e dytë në vijim:

1. Besimi se ka një qenie reale që e ka aftësinë ta sfidojë:

- Krijuesin në krijimin e Tij ose
- Zotëruesin e kësaj mbretërie në zotërimin e Tij ose
- Atë që i rregullon të gjitha çështjet në mënyrën si Ai i rregullon ato çështje;

pa pasur nevojë për pranimin ose lejimin e plotë nga Ai. Ose ajo qenie ka aftësinë:

- Të marrë nga vullneti i Tij hyjnor

Edhe kjo është shirk, edhe nëse personi që e mban këtë besim beson po ashtu se Allahu është Krijuesi, Zotëruesi i kësaj mbretërie dhe Ai i cili i rregullon të gjitha çështjet. Kjo sepse aftësia e asaj qenie për të marrë nga vullneti i Allahut, nëpërmjet këtyre cilësive, bie në kundërshtim me karakteristikën e sovranitetit të vërtetë dhe e anulon përsosurinë absolute.^[10] Kësisoj edhe shumë arabë të xhahilijetit besonin se Allahu ishte Krijuesi, Furnizuesi dhe Ai që i rregullon të gjitha çështjet, si në ajetin:

“Nëse ti (o Muhamed) i pyet ata (mekasit paganë) se kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën, me siguri që do të të thonë: Allahu”. (ez-Zumer, 38)

Dhe

“Nëse ti i pyet ata se kush e zbret ujin nga qielli dhe nëpërmjet tij e gjallëron tokën pas vdekjes së saj, me siguri se ata do të të thonë “Allahu!” Thuaj: “Qoftë lëvduar Allahu!” Por shumica e tyre nuk mendojnë”. (el-Ankebut, 63)

Por ata arabë besonin se ata zota kishin një ndikim në aftësitë dhe urdhrat e Zotit. Gjendja e arabëve të xhahilijetit në përfytyrimin e tyre përplot shirk ishte e ngjashme me gjendjen e një mbreti me guvernatorët e tij; mbretëria thuhet se i takon mbretit, por guvernatorët kanë autoritet dhe rolet kryesore në çështjet e shtetit. Vetë mbreti (pronari) nuk mund t'i anulojë plotësisht vendimet e guvernatorëve të tij as një herë të vetme. Ndonëse thuhet se mbretëria është nën kontrollin e tij,

gubernatorët kanë ndikim të madh në çështjet e shtetit, meqë ai detyrohet t'u nënshtrohet kërkesave të tyre, për shkak të ndonjë nevoje të kohëpaskohshme për ta. Allahu është i lartë që të ketë një këso nevoje primitive. Ky ishte imazhi i shumë arabëve politeistë lidhur me zotat që i adhuronin krahas Allahut të lartë. Ky lloj shirku është në qeverisje.

Për sa i përket qeverisjes në mbretërinë e Allahut me lejen e Tij, kjo nuk bie ndesh me Teuhidin. Kjo nuk nënkupton t'i atribuosh ndonjë cilësi të veçantë për Zotin dikujt tjetër veç Tij. Ne besojmë se ka melaike të cilat janë të autorizuarat për furnizim dhe për marrje të shpirtrave pas vdekjes, dhe që disa robërve të Tij u janë dhënë aftësi / mundësi të tjera me lejen e Tij. I këtillë është edhe rasti i Isës u:

“... bëj për ju diçka prej balte në formë shpendi, fryj në të e, me urdhrin e Allahut, ajo bëhet shpend i gjallë; shëroj të verbrit e lindur dhe të lebrurit, i ngjall të vdekurit me lejen e Allahut, dhe ju tregoj çfarë hani dhe çfarë ruani në shtëpitë tuaja”. (Ali Imran, 49)

Secila nga këto cilësi është e veçantë për Zotin,^[11] sepse nënkuptojnë ose krijim, ose qeverisje të çështjeve që janë të veçanta për Zotin. Por asgjë nga kjo nuk heq nga Zotërimi (Rububije) i Allahut. Kjo sepse krijesat i bëjnë këto akte me lejen e Allahut:

- Pa pasur Allahu ndonjë nevojë për krijesat e Tij në këto situata dhe
- Pa marrë ndonjë gjë nga mbretëria e Allahut ose nga pushteti i plotë i Tij mbi të nënshtruarit e Tij.

Kjo është arsyeja përse Allahu i mohoi këto dy lloje të ortakërisë (shirkut):

1. Shirkun e shumësisë së krijuesve, pronarëve dhe rregulluesve të të gjitha çështjeve, dhe
2. Shirkun e nevojës për një mbrojtës, për shkak të dobësisë

Allahu e lartësoi veten e Tij nga këto të meta në thënien e Tij:

“Thuaj: “Çdo lavd e falënderim i përket Allahut, i Cili nuk ka bir, nuk ka ortak në pushtet dhe nuk është i pafuqishëm që të ketë nevojë për ndihmës” dhe madhëro Atë duke e ngritur lart madhësitinë Tij!” (el-Isra, 111)

Ibn Xherir (v.310 H), në tefsirin e tij lidhur me këto ajete, thotë: “Allahu – e lartësuar qoftë përmendja e Tij – i thotë pejgamberit të Tij: Thuaj, Muhamed, tërë lavdi i takon Allahut, ‘i Cili s’ka fëmijë e as ortak’, meqë atëherë Ai do të ishte një zot më i vogël, jo një zot si i ka hije. Një Zoti të zotave nuk i ka hije të ketë fëmijë ‘e as ortakë në pushtetin e Tij’, sepse kjo, medoemos, do të nënkuptonte paaftësi dhe mbështetje në një tjetër, gjë që do të ishte shfaqje e dobësisë. Një qenie nuk është perëndi, nëse ka nevojë për një tjetër në përmbushjen e nevojave. Po ashtu nuk do të konsiderohej perëndi, nëse ajo nuk do të ishte e vetme në mbretërinë dhe sovranitetin e vet. ‘Nuk është i pafuqishëm që të ketë nevojë për ndihmës’, domethënë askush s’ka bërë një marrëveshje me Të, për shkak të dobësisë së Tij. Nëse një qenie ka nevojë për ndihmën e tjetrit, atëherë është e dobët dhe e ulët. Çfarëdo qoftë që është e dobët, e ulët dhe ka nevojë për dikë t’i japë fitore, nuk është perëndi që meriton dëgjueshmëri. ‘Madhëro Atë duke e ngritur lart madhësitinë Tij’, domethënë përndero Zotin tënd, o Muhamed, me atë që të kemi urdhëruar, qoftë me fjalë, qoftë me vepra; dëgjo Atë në atë për çfarë të urdhëron dhe përmbahu nga ndalimet e Tij”.

Ngjashëm, ne përmendëm në thënien e tij ‘Nuk është i pafuqishëm që të ketë nevojë për ndihmës’ se dijetarët e tefsirit kanë thënë që ... (përmend zinxhirin e transmetimit deri të Muxhahidi lidhur me

thënien e Allahut ‘Nuk është i pafuqishëm që të ketë nevojë për ndihmës’): Ai s’ka ndonjë marrëveshje me ndokënd për ndihmë e as nuk e dëshiron ndihmën e ndokujt.[12]

Ibn Kethir (v.774H) përmend në tefsirin e tij: “Ai nuk është i pafuqishëm që të ketë nevojë për ndihmës’, domethënë Ai nuk është i dobët, kështu që Ai s’ka nevojë për një mbrojtës ose këshilltar. Në të vërtetë, Ai është krijuesi i vetëm i të gjithëve, pa ndonjë ortak, Ai që i qeverisë të gjithë, Ai që e përcakton fundin e të gjithëve sipas vullnetit të Tij, i pashoq”. [13]

Sudi (v. 127H) u parapriu këtyre dyve në tefsirin e tij duke thënë: “Ai nuk është i pafuqishëm që të ketë nevojë për ndihmës’, domethënë që ta kërkojë mbështetjen e atij ndihmësi”. [14]

Ibn ebi Zemenaajn (v. 399H) tha: “Thuaj: Çdo lavd e falënderim i përket Allahut, i Cili nuk ka bir’, me qëllim që ta shtojë numrin. ‘As nuk ka ortak në pushtet’, domethënë ortak që krijon krahas Tij. ‘Ai nuk është i pafuqishëm që të ketë nevojë për ndihmës’, domethënë që të kërkojë mbështetje nga ai”. [15]

Ky imazh i një ndihmësi, për shkak të dobësisë, është një imazh të cilin e kanë harruar institucionet edukative islame kohëve të fundit. Ata kanë arritur ta kufizojnë shirkun e arabëve vetëm në veprime të gjymtyrëve, edhe nëse veprimi i individit nuk shoqërohet me besimin se ka të bëjë me një zot. Kjo harresë është arsyeja përse përjashtohen nga Islami edhe njerëzit që i kanë deklaruar dy dëshmitë (*la ilahe il’laAllah, Muhammedun resulullah*).

Kushdo që mendon që shirku i arabëve është jashtë dy përskrimeve (më lart) të shirkut, gabon rëndë dhe sjell diçka që çdo individ i arsyeshëm do ta refuzonte. Një beduin arab kërkonte ndihmë dhe mbështetje nga dikush si vetë ai. Po ashtu, ai i kërkonte zotit (idhullit) të tij që ta ndihmonte e ta mbështeste. Atëherë, çfarë ishte ajo në zemrën e atij arabi që e bëri idhujtar, kur kërkoi nga idhulli i tij? Dhe çfarë ishte ajo që e pengoi hyjnizimin e të tjerëve si ai vetë (pos idhullit), kur kërkoi prej tyre? Ky beduin arab iu drejtua një perëndie të supozuar, për shkakun se ndjeu që ajo perëndi (idhull) e kishte aftësinë të ndikonte në rendin e Allahut, njësoj si në rastin e të dobët që kërkon mbështetje, siç përmend Zoti ynë në librin e Tij fisnik. Allahu sqaron se besimi i një besimtari nuk do të pranonte t’i atribuoheshin këso të meta Atij. Zemra dhe gjuha e tij do t’i drejtoheshin me lavd dhe përnderim Atij që ‘nuk ka bir, nuk ka ortak në pushtet dhe nuk është i pafuqishëm që të ketë nevojë për ndihmës’.

Për sa u përket atyre që këmbëngulin në ajetin “Sa për ata që marrin mbrojtës të tjerë përveç Tij, duke thënë: Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu” (ez-Zumer, 3), duke thënë se shirku i arabëve të xhahilijetit qe shirk në adhurimin e tyre, jo në refuzimin e tyre të teuhidit të Zotërimin të Allahut (Rububije), kjo është këmbëngulje në të kotën, që nuk mbështetet nga kuptimi i adhurimit. Realiteti i adhurimit e kërkon që të mos mohohet, përveç nëse objektit të adhuruar i atribuohet cilësi prej Zoti.

Arabët e njihnin më së miri kuptimin e fjalës “adhurim”, që është edhe arsyeja përse thuhet qartazi “Ne u lutemi atyre ...” Këtu nuk përmendet ndonjë shprehje tjetër, si:

- “Ne u kërkuam atyre ...” ose
- “Ne i lartësojmë ata ...”

Kjo sepse fjalët “kërkim” dhe “lartësim” nuk e paraqesin si duhet realitetin e adhurimit, ndonëse të dy këta terma janë të përshtatshëm për krijesat që i drejtohen krijuesit. Ti, për shembull, mund të thuash “Unë i lartësoj pejgamberët dhe të drejtët, dhe unë e lartësoj Qabenë”. Njësoj ti mund të thuash “Unë e

lartësoj Allahun, Zotin e njerëzve”. Në këtë lartësim nuk ka dallim, përveç faktit se lartësimi që ti i bën Allahut është lartësim i një robi drejtuar Zotit të tij, pra, një krijesë që i drejtohet Krijuesit të vet. Kjo është arsyeja përse arabët e shprehnin atë që e paraqet realitetin e tyre, që është fjala “adhurim”. Ky kuptim është bërë i qartë gjatë këtij diskutimi.

Për sa u përket veprave, qofshin ato të zemrës, qofshin të gjymtyrëve, s’është e rëndësishme se a janë “adhurim”. Përjashtimi nga kjo është vetëm kur nijeti për veprën është kërkimi i afrimit me qenien për të cilën besohet se ka cilësi që janë të veçanta për Zotin. Krahas kësaj, është e pamundur për një musliman që ta dojë, t’ia ketë frikën, ose të shpresojë te dikush tjetër veç Allahut e të mos konsiderohet idhujtar, nëse do ta bënte këtë.

Edhe Shejh el-Islam ibn Tejmije e pohon këtë në deklaratën e tij: “Ai – lavdërim qoftë përmendja e Tij – sqaron se vetëm Ai është i denjë për t’u adhuruar pa u adhuruar ndokush tjetër krahas Tij. S’ka të ngjashëm me Të. Ai e ka cilësinë e përsosurisë, një cilësi e përhershme që u mungon të gjithë atyre që adhurohen krahas Tij, qoftë duke i atribuuar Atij fëmijë, qoftë ortakë. Lidhur me thënien e Tij: ‘Thuaj: Nëse përveç Atij do të kishte edhe zota të tjerë, siç thonë ata, atëherë ata do të kërkonin rrugë për të arritur te Zoti i Fronit’ (el-Isra, 42), idhujtarët arabë thoshin se ata zota do të ndërmjetësonin për ta dhe do t’i afronin më shumë me Të. Këtë ndërmjetësim ata e atribuonin pa lejen e Tij, çka nënkupton që ky ndërmjetësim të jetë në dorën e krijesave, gjë që përbën një lloj shirku. Për këtë Allahu thotë: ‘Ata që u adhurojnë në vend të Allahut, nuk do të mund të ndërmjetësojnë për askënd, përveç atyre që dëshmojnë për të Vërtetën dhe e dinë mirë (se s’ka Zot tjetër të vërtetë veç Allahut)’ (ez-Zuhruf, 86), duke treguar kështu se askush nuk e ka mundësinë e këtij ndërmjetësimi, përveç Allahut”.[\[16\]](#)

Këtu, Shejhul-Islami e sqaron llojin e shirkut të politeistëve me idhujt e tyre për sa i përket ndërmjetësimit. Ai u shpreh: “Ata e atribuonin ndërmjetësimin pa lejin e Tij”. Me gjithë këtë qartësim, unë po përmend këtu një numër tekstesh nga Kurani, përfshirë ajetin e përmendur më herët nga sureja el-Isra (“Dhe nuk është i pafuqishëm që të ketë nevojë për ndihmës”), që tregon se si politeistët i shihnin zotat e tyre. Më i Larti thotë:

“Apo ata kanë zota të tjerë, të cilët mund t’i mbrojnë prej Nesh? Këta nuk mund të ndihmojnë as veten dhe askush nuk mund t’i marrë në mbrojtje kundër Nesh”. (el-Enbija, 43)

Në këtë ajet, Allahu e definon besimin e rremë të arabëve për zotat e tyre dhe mënyrën si ata i mbronin nga Allahu. Lidhur me ajetin “Apo ata kanë zota të tjerë, të cilët mund t’i mbrojnë prej Nesh?”, Ibn Kethir thotë në tefsirin e tij se kjo është një “pyetje zhvlerësuese”,[\[17\]](#) që përdoret për qortim. Domethënë, a kanë ata zota të tjerë veç Neve që i mbrojnë? Pra, nuk është ashtu siç supozoni ju.[\[18\]](#)

Arabët supozonin (siç përmend Ibn Kethiri) se sovraniteti i zotave të tyre e tejkalon sovranitetin e Allahut të lartësuar qoftë dhe ndonjëherë. Për këtë arsye u kuptua se ata arabë i adhuronin zotat e tyre. Hyjnizimi, në të vërtetë, nuk ndodh në ndonjë kuptim tjetër. Sikur të mos ishte kështu, arabët do t’i barazonin zotat e tyre me krijesat e tjera (njerëz, gurë, pemë).

Allahu thotë: “Thuaj: Nëse përveç Atij do të kishte edhe zota të tjerë, siç thonë ata, atëherë ata do të kërkonin rrugë për të arritur te Zoti i Fronit”. Këtu, Allahu i vë në dijeni politeistët arabë se, sikur ta krahasonim besimin tuaj në zotat tuaj – me supozimin se kjo është e saktë – dhe ata të posedonin njëmend cilësi prej perëndie, kjo do ta bënte të domosdoshme që ata ta sfidonin sovranitetin dhe mbretërimin e Allahut.[\[19\]](#) Kjo thënie bindëse nuk do të qëndronte, po që se ata nuk do t’u atribuonin idhujve të tyre cilësi që janë të veçanta për Zotin. Të supozojmë se arabët politeistë nuk besonin se

idhujt e tyre kishin cilësi që janë të veçanta për Zotin dhe as aftësinë për ta qeverisur krijimin ose për të dhënë urdhra, përveç nëse kjo bëhet nën sovranitetin e plotë të Allahut dhe në qeverisjen dhe kontrollin e plotë të Tij. Ata, me siguri, do t'i përgjigjeshin këtij ajeti: Si bën të na imponohet ky kuptim ndërsa po thuhet se ne i shohim këta idhuj si robër të pafuqishëm, të paaftë për të dhënë urdhra! Si mundin këto qenie ta sfidojnë Atë që i krijoi! Çfarë përgjigje është kjo e cilësive që ne (kinse) nuk i gjejmë në këto krijesa të pafuqishme?

Ky ajet e përcakton qartë realitetin e adhurimit në ajetin “Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu”. Adhurimi i tyre e përfshinte lartësimin deri në pikën ku ata i atribuonin cilësi të Zotit dikujt tjetër veç Allahut të madhërishtëm.

Meqë mund të thuhet se dallimi mes këtyre pikëpamjeve varet nga mënyra e qasjes ndaj ajeteve të përmendura më herët, unë po parashtroj dy ajete të tjera. Këto dy ajete janë plotësisht të qarta në atë çfarë synojnë dhe nuk lënë mundësinë që të kuptohen ndryshe.

Allahu thotë: “Allahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe, përveç Atij, s’ka asnjë zot tjetër, përndryshe çdo zot do ta merrte atë që ka krijuar dhe do të ngriheshin njëri mbi tjetrin. Qoftë i lartësuar Ai nga shpifjet e tyre!” (el-Mu’minun, 91)

Ai po ashtu thotë: “Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka, do të shkatërroheshin. I lartësuar është Allahu, Zoti i Fronit, nga çfarë thonë ata!” (el-Enbija, 22)

Dy shembuj të keqkuptimit të teuhidit

Në prezantimin e sipërm shohim dallimin mes dy mendësive në vijim, që shumë nga shkruarit e ditëve të vona përfaqësojnë.

Mendësia e parë:

Këta u referohen parimeve të përjashtimit nga Islami (bëjnë tekfir) atëherë kur individ i shoqëron ortakë në adhurim Allahut, pa e përfshirë në këtë teuhidin e Zotërimit (*Rububije*). Këta pohojnë se politeistët arabë nuk ranë në shirkun e Zotërimit dhe shkelja që ata bënë, në të vërtetë, ishin veprimet e tyre (me gjymtyrë) të cilat ua drejtonin të tjerëve veç Allahut. Ithtarët e kësaj pikëpamje, nuk bëjnë dallim mes veprimit që përbën shirk në adhurim dhe atij që nuk përbën shirk në adhurim. Këta e përjashtojnë individin nga Islami atëherë kur ai ia drejton adhurimin me gjymtyrë dikujt tjetër veç Allahut, edhe nëse ai s’e kupton se në këtë mënyrë po e shkel teuhidin e Zotërimit. E vërteta këtu është si në vijim:

- Së pari, nuk ka ndonjë kufizim në ndalimin e lënies së adhurimit që është i veçantë për Zotërimin e Allahut (*Rububije*).[\[20\]](#)
- Së dyti, tekfiri kufizohet në shirkun e adhurimit, kurdo që individ i lë adhurimin që është i veçantë për Zotërimin e Allahut.

Kjo shkelje e Zotërimit (rububijeh) të Allahut pothuajse nuk ndodh kurrë (sidomos në mesin e atyre që i shprehin dy dëshmitë e besimit) vetëm duke i kushtuar një veprim me gjymtyrë dikujt tjetër veç Allahut, që normalisht nuk është e lejueshme t’i drejtohet dikujt tjetër veç Tij. Për sa kohë që këta njerëz t’i

deklarojnë dy dëshmitë e besimit, nuk është e lejueshme t'i përjashtosh nga Islami. Përjashtim nga kjo do të ishte rasti kur do ta dinim sigurt se personi e bën atë veprim me gjymtyrë (p.sh. sexhde) me nijetin e shkeljes së Zotërimit (të Allahut). Nëse kjo bëhet krejtësisht e qartë, atëherë personi, vërtet, është jobesimtar. Individët e këtillë nuk do të arsyetoheshin me mosdije dhe nuk do të duhej të pohonim më Islam për ta, sepse këta njerëz (që e shkelin teuhidin e Zotërimit), në të vërtetë, janë të ngjashëm me politeistët arabë, të cilët deklarorin: “Në shërbimin Tënd, o Allah, në shërbimin Tënd. Ti s'ke ortakë, përveç ortakëve që të takojnë Ty. Ti e posedon atë (ortakun), kurse ai nuk posedon gjë”. Kjo deklaratë synon ta konfirmojë teuhidin duke shprehur atë që e mohon teuhidin, pra, përbën një kontradiktë të qartë.

Mendësia e dytë:

Këta i përkufizuan veprimet e ndaluara në atë që konsiderohet shirk në adhurim, pa i llogaritur në këtë edhe veprimet që Sheriati i vlerëson si të palejueshme. Kjo ndodhi për shkakun se ata nuk i kuptuan disa prej veprimeve që i pandehnin për të palejueshme, kurse, në të vërtetë, Sheriati ka lejuar që ato t'u drejtohen krijesave në shenjë respekti. Këto veprime bëhen edhe nga individë që konsiderohen të drejtë dhe kanë moral të mirë. Ky grup e lejoi:

- Tavafin rreth varreve
- Bërjen kurban afër varreve ose për to, me qëllim të nderimit të të vdekurit.
- Sexhden dhe fshirjen e pëllëmbëve për një varr të caktuar.
- Kërkimin e përmbushjes së nevojave personale nga këta të vdekur, me idenë e ndërmjetësimit të tyre te Allahu.

Tërë kjo bëhet nga mosdija për faktin se këto veprime janë të palejueshme, edhe nëse i drejtohen krijesës më të mirë, Muhamedit r.

Përmbyllje

Për fund themi se u bë qartë që e vërteta qëndron në mes të këtyre dy mendësive. Mendësia e parë nuk e kupton moslejimin e bërjes së tekfirit ndaj individëve që nuk e meritojnë. Mendësia e dytë është e gabuar në atë se lejon që veprimet e jashtme të adhurimit, që janë të veçanta për Allahun si Zot, t'u drejtohen të tjerëve. Këta e lejojnë këtë me bindjen se nuk po e shkelin Zotërimitin e Allahut në këtë mënyrë.

Të dyja këto gabime do të mund të shmangeshin, sikur këto dy grupe ta kishin të qartë kuptimin e saktë të adhurimit.

E lus Allahun të na i bashkojë zemrat në të vërtetën dhe të na falë për mangësitë dhe gabimet që kemi!

Allahu, sigurisht, e di më së miri.

Referenca

- [1] Shirk (arabisht): T'i bësh ortakë Allahut. Ky koncept sqarohet më tej përgjatë kësaj broshure.
- [2] Ky përkufizim i njohur është marrë nga Shejh el-Islam ibn Tejmije. Shih *Mexhmu el-Fetava* (16/149).
- [3] Unë e nisa me mundësinë e fitimit e shpërblimit, sepse ka material që nuk ndërlidhet me këtë hulumtim. Kjo bëhet më e qartë me shembullin e dytë të ngrënies, të pirjes dhe të fjetjes. Të gjitha këto nuk u bëjnë dobi të tjerëve.
- [4] Në një hadith autentik: “Në marrëdhëniet intime që ju bëni ka sadaka”. Thanë: “Ne shpërblehemi edhe për këtë!?” Ai tha: “A nuk merreni në përgjegjësi, nëse bëni marrëdhënie intime të palejueshme? Kjo është e vlefshme edhe për të lejueshmen, pra, ka shpërblim”. Vetë hadithi e sqaron kushtëzimin për marrjen e shpërblimit, që është kryerja e këtij akti me të cilin ai e mbron veten nga ajo që s’është e lejueshme. Ai më tej sqaron nijetin – ndër nijetet e tjera – që e bën të domosdoshme shpërblimin nga Allahu për personin që e përmbush epshin e tij. Ky nijet e mbron personin me të lejueshmen nga e palejueshmja. Kjo qëndron pa fije dyshimi, sidomos kur ky hadith ka karshi parimin përcaktues në hadithin: “Veprimet gjykohe sipas nijetit për to, kështu që secili do të gjykohet sipas nijetit që ka pasur. Kushdo që shpërngulet për Allahun dhe për të Dërguarin e Tij, shpërngulja e tij do të jetë për ta; kushdo që shpërngulet për këtë botë ose për t’u martuar me ndonjë grua, atëherë udhëtimi i tij do të gjykohet për nijetin që ai ka pasur”.
- [5] Siç u qartësua në seksionin paraprak, ku u përfshinë respektimi i prindërve / mysafirëve, pirja e ujit, etj.
- [6] Siç do të qartësohet, me lejen e Allahut, në këtë seksion.
- [7] Ai që e kontrollon tërë krijimin, Ai që e zotëron Mbretërinë, Ai që i rregullon të gjitha çështjet, Ai që përshkruhet me përsosuri absolute.
- [8] Si në fusnotën më sipër.
- [9] Sahih Muslim #756.
- [10] Një shembull i përshtatshëm i kësaj janë zotat grekë dhe romakë. Ata besonin se zoti suprem, Zeusi, i ka krijuar të gjithë zotat e tjerë dhe i zotëronte të gjithë ata. Madje, të qenët e Zeusit një perëndi eprore nuk e parandalonte të sfidohej nga këto perëndi më të vogla që ai vetë i kishte krijuar.
- [11] Siç është krijimi, furnizimi dhe kthimi në jetë nga vdekja, etj.
- [12] Tefsir et-Taberi (15/137-138).
- [13] Tefsir ibn Kethir (5/130).
- [14] Tefsiri Jahja ibn Selaam (1/169).
- [15] Tefsir ibn ebi Zemenaajn (3/46).
- [16] Mexhmu el-Fetava (16/121-122)

[17] Një pyetje që përdoret për ta përcëmuar subjektin që i drejtohet pyetja.

[18] Tefsir ibn Kethir (5/130).

[19] Shejh Muhamed el-Emin esh-Shenkiti përmend në Adva el-Bejan: “Ky ajet fisnik mund të kuptohet në dy mënyra dhe që të dyja janë me vend, pra, Kurani i mbështet të dyja këto kuptime. Për hir të ndershmërisë intelektuale, po i përmendim të dyja kuptimet:

Së pari, sikur të kishte një zot tjetër veç Allahut, siç pohojnë jobesimtarët, (“ata do të kërkonin rrugë”), domethënë ky zot i supozuar do të synonte (“rrugë për të arritur te Zoti i Fronit”) Allahun. Me fjalë të tjera, ata do të kërkonin mënyra për ta përmbysur Atë dhe për ta zaptuar mbretërinë e Tij, meqë do të ishin të barabartë me Të, ngjashëm siç bëjnë mbretërit me njëri-tjetrin. Tërë lavdi qoftë për Allahun, i cili është madhështor dhe i lartë nga këto gjëra të parëndësishme. Ky është një prej interpretimeve që më erdhi ndër mend lidhur me këtë ajet. Disa ajete që e mbështesin këtë kuptim përfshijnë: “Allahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Atij s’ka asnjë zot tjetër, përndryshe çdo zot do të merrte atë që ka krijuar dhe do të ngriheshin njëri mbi tjetrin. Qoftë i lartësuar Ai nga shpifjet e tyre! Ai di të padukshmen dhe atë që shihet. Ai është shumë lart mbi zotat që ia quajnë Atij për shok!” (el-Mu’minun, 91-92) dhe “Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka, do të shkatërroheshin. I lartë është Allahu, Zoti i Fronit, nga çfarë thonë ata!” (el-Enbija, 22). Ky është kuptimi që u përcoll nga Ibn Abbas, Sa’id ibn Xhubejr, Ebu Ali el-Faarisi, en-Nukaash, Ebu Mensur, dhe të tjerë veç këtyre nga dijetarët e kelamit.

Së dyti, kuptimi i “ata do të kërkonin rrugë për të arritur te Zoti i Fronit”, domethënë do t’i merrnin ata si mjet / mënyrë dhe si ndërmjetësues për t’iu afruar Atij në njohje të vlerës së Tij. Kjo mbështetet nga thënia e Allahut “Vetë ata që idhujtarët u luten (melaiket), kërkojnë t’i afrohen Zotit të tyre, madje edhe më të afërtit, duke shpresuar mëshirën e Tij dhe duke iu frikësuar dënimit të Tij. Me të vërtetë, nga dënimi i Zotit tënd duhet të ruhet gjithkush” (el-Isra, 57). Ky kuptim u përcoll nga Katade dhe më këtë u mjaftua edhe Ibn Kethiri në tefsirin e tij.

Sigurisht që kuptimi i parë të vjen ndër mend i pari nga ana gjuhësore. Kjo për shkak të situatës së pamundur që krijohet në vetë ajetin, që nënkupton praninë e një zoti të barabartë me Allahun. Cili do të ishte qëllimi i afrimit me Allahun, kur zoti tjetër është i barabartë me Të! Kjo krijon një situatë të pamundur dhe Allahu është i gjithëdijshëm për çdo gjë.” (Adva el-Bejaan, 3/-595-595)

Po ashtu shih el-Basit të el-Wahidi (13/343-344), el-Wesit nga i njëjti autor (3/109), el-Muharrir el-Wexhiz nga Ibn Atijeh (5/484-485), dhe Rumuz el-Kunuz nga Ras’ani (4/174). Shejh el-Islam ibn Tejmije ia atribuon kuptimin e parë Sufjan eth-Theurit (në Mexhmuan e tij, 16/122).

[20] (Shënim i përkthyesit) Domethënë, lënia e çdo adhurimi që është i veçantë për Zotërimin e Allahut është e dënueshme në çdo rast.

Date Created

29/11/2024

Author

erasmusi